

VENDIM
Nr.840, datë 20.12. 2003

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË OFERTUESVE DHE SHPALLJEN E FITUESIT, NË
TENDERIN E HAPUR NDËRKOMBËTAR, PËR PRIVATIZIMIN E BANKËS SË
KURSIMEVE SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8563, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a.”, i ndryshuar dhe të vendimit nr.452, datë 28.6.2001 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave të privatizimit dhe të termave të kontratës së shitjes së aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a.”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së ofertuesve, sipas raportit të Komisionit të vlerësimit të ofertave, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e Raiffeisen Zentralbank Österreich AG, fituese për blerjen e aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a., në masën 100 për qind, me vlerë 126 000 000 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë) USD, me çmim për çdo aksion 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) USD.

3. Forma dhe mënyra e pagesës të jetë në *cash*.

4. Ngarkohet Ministri i Financave për nënshkrimin e kontratës përfundimtare me fituesin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**RAPORTI I KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE TË TENDERIT
PRIVATIZIMI I BANKËS SË KURSIMEVE SHA**

a) Objekti i ofertës dhe numri i aksioneve të vëna në shitje

Mbështetur në ligjin nr.8563, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a.”, i ndryshuar, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 28.6.2001, i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.630, datë 18.9.2003, Banka e Kursimeve sh.a. iu nënshtrua procedurave të privatizimit.

Bazuar në formulën e privatizimit, të përcaktuar në ligjin e sipërpërmendur për privatizimin e Bankës së Kursimeve sh.a., u zbatua procedura e tenderit të hapur ndërkombëtar, duke vënë në shitje jo më pak se 35 për qind të aksioneve.

Për këtë qëllim, Ministria e Financave gjatë gjithë vitit 2003 ka punuar mbi bazën e një plani veprimesh, në të cilin u përcaktuan të gjitha hapat që do të ndërmerreshin në funksion të privatizimit.

Në përputhje me procedurat e tenderimit të Bankës Botërore dhe të financuara prej saj, u përzgjedhën këshilltari i privatizimit dhe këshilltari ligjor, të cilët asistuan gjithë procesin.

Gjithashtu, gjatë vitit 2003 u realizua auditimi i bilancit të vitit 2002 dhe të 6-mujorit të parë të vitit 2003 të Bankës së Kursimeve sh.a. nga shoqëria audituese “Deloitte & Touche”.

Përveç auditimit u krye dhe vlerësimi i Bankës së Kursimeve (një kopje të të cilit e gjeni bashkëlidhur) nga shoqëria KPMG.

Gjithashtu, gjatë vitit 2003 Banka e Kursimeve vazhdoi t’i nënshtrohej rristrukurimit, për ta bërë Bankën sa më tërheqëse për investitorët strategjikë.

Gjatë muajit qershor 2003, Ministria e Financave filloi procesin e marketingut, i cili konsistoi në kontakte me disa banka të interesuara për blerjen e aksioneve të saj. Ky proces vazhdoi edhe gjatë muajit shtator 2003, madje në mënyrë më intensive e duke u përqëndruar kryesisht tek bankat që shprehnin interes më të madh.

Në muajin shtator Ministria e Financave publikoi ftesën për tender në gazetën ndërkombëtare “Financial Times”, si dhe në disa gazeta lokale.

Bazuar në planin e veprimeve, bankat që shprehin interes ishin OTP (Hungari) dhe Raiffeisen (Austri), të cilat iu nënshtruan procedurave të tenderit për parakualifikim. Komisioni i vlerësimit të

ofertave, bazuar në procedurat e tenderit, në fazën e parakualifikimit (Aneksi 1), vendosi t'i parakualifikojë të dyja bankat dhe njëkohësisht t'ua dërgojë atyre vendimin e parakualifikimit, si dhe ftesën për të kryer Due-Diligence. Gjatë muajit nëntor 2003 ato e kryen të dyja këtë proces.

Më pas, me asistencën e këshilltarit ligjor ndërkombëtar, u hartua kontrata e shitjes së aksioneve të Bankës së Kursimeve, e cila, në përputhje me procedurat e përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për disa ditë me radhë u negociua me të dyja bankat dhe pas këtyre negociatave u dërgua për miratim versioni përfundimtar i kontratës në Këshillin e Ministrave, që me vendimin nr.823 të datës 11.12.2003 bëri miratimin e saj. Kjo kontratë, në formën e miratuar nga Këshilli i Ministrave, ishte një ndër dokumentet e ofertës, e cila duhej të paraqitej e nënshkruar, pa ndryshime, nga secili ofertues. (Kjo gjë iu bë e ditur të dy ofertuesve përmes një letre të Ministrit të Financave, që i bashkëlidhet këtij raporti.)

b) Përmbledhje e procedurës dhe numri i ofertave të paraqitura

Më datë 17.12.2003, në orën 9:30, sipas ftesës për tender, Komisioni i vlerësimit të ofertave e deklaroi të hapur tenderin për privatizimin e Bankës së Kursimeve, në prani të mediave.

Të dy ofertuesit filluan të dorëzonin dokumentacionin e kërkuar në "Ftesën për tender". OTP-ja dorëzoi zarfin me dokumentacionin e "Plotësimit të kushteve paraprake", një zarf me "Ofertën financiare" dhe zarfin me "Ofertën teknike". Ofertuesi Raiffeisen dorëzoi zarfin me dokumentet për "Plotësimin e kushteve paraprake" dhe kërkoi që zarfin me "Ofertën financiare" dhe atë të "Ofertës teknike" t'i dorëzonte në orën 12:30, pasi Komisioni të kishte shqyrtuar dokumentet e zarfit me dokumentet për "Plotësimin e kushteve paraprake", pasi mendonin se nuk duhej të procedohej më tej, në rast se banka Raiffeisen nuk i plotësonte kushtet paraprake. Pas refuzimit të kësaj kërkesë nga ana e Komisionit, Raiffeisen pranoi të dorëzonte edhe zarfin me "Ofertën financiare" dhe atë të "Ofertës teknike".

Më pas, Komisioni vazhdoi procedurën për verifikimin dhe kontrollin e dokumenteve të paraqitura nga ofertuesit. Nga verifikimi dhe kontrolli formal i tyre rezultoi se bankat pjesëmarrëse i kishin paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara nga procedurat e tenderit, pra (1) dokumentacionin për përmbushjen e kushteve paraprake (2) ofertën financiare dhe (3) ofertën teknike. Komisioni vendosi që ofertat të hapeshin me radhë sipas rendit alfabetik, pra duke filluar me ofertuesin OTP dhe më pas duke vazhduar me ofertën e ofertuesit Raiffeisen Bank. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të zarfit me kushtet paraprake të ofertuesit OTP, Komisioni konstatoi se ndryshimet në kontratë fillonin nga faqja 5 e kontratës së shitjes së aksioneve, konkretisht paragrafi 2 dhe 3. Kërkesat e procedurave të tenderit kërkojnë që kontrata duhej të paraqitej e nënshkruar nga ofertuesi OTP, e pandryshuar, sipas variantit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.823 të datës 11 dhjetor 2003. Të njëjtën shkelje Komisioni konstatoi edhe në kontratën e shitjes së nënshkruar nga ofertuesi Raiffeisen, që kishte bërë ndryshim duke filluar nga faqja 11, paragrafi 7.1.17.10 të saj. Në këto kushte Komisioni gjykoi se nuk duheshin vazhduar procedurat për hapjen e ofertës teknike dhe të asaj financiare të asnjërit ofertues. Gjithashtu, Komisioni gjykoi të udhës të thërriste përfaqësuesit e të dy ofertuesve dhe, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 28.6.2001, që të jepnin informacion shtesë, pra të paraqitnin kontratën e nënshkruar sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ofertuesit e pranuan këtë sugjerim dhe kërkuan kohë për të siguruar dhe paraqitur kontratën e mësipërme, dhe konkretisht u caktua ora 18:45.

Ofertuesi Raiffeisen dorëzoi menjëherë kontratën e nënshkruar pa ndryshime, ndërsa ofertuesi OTP kërkoi fillimisht një orë kohë për ta paraqitur kontratën, pastaj njoftoi se i duhej një kohë më e gjatë dhe kërkoi orën 19:45, por edhe këtë herë nuk u paraqit në orën e ricaktuar, por në ora 20:30 dhe i dorëzoi Komisionit një letër në të cilën deklaronte mospranimin për të paraqitur kontratën e nënshkruar pa ndryshime, edhe pse është kusht i domosdoshëm për respektimin e procedurave të tenderit. Ofertuesi OTP kërkoi vazhdimin e procedurave me kontratën e nënshkruar, me ndryshime, të dorëzuar në orën 9:30. Duke mos gjetur zgjidhje tjetër, të lejueshme nga legjislacioni i privatizimit dhe procedurat e tenderit, Komisioni vendosi të vazhdojë procedurën e tenderit, duke marrë vendim për të hapur ofertën financiare të bankës Raiffeisen, si ofertues që përmbushte kushtet paraprake.

Më pas, kryetari i Komisionit, në prani të përfaqësuesve të të dy ofertuesve dhe të medias, konform procedurave ligjore, hapi ofertën financiare të ofertuesit Raiffeisen dhe e lexoi atë me zë. Oferta financiare e paraqitur shpallte çmimin total të blerjes së 7000 aksioneve, përkundrejt çmimit për aksion 18 000 USD, baras me 126 milionë USD.

Më datë 19 dhjetor 2003, OTP-ja dorëzoi një letër në protokollin e Ministrisë së Financave me

nr.8626/4 në të cilën pranohet ndryshimi i kontratës vetëm në disa terma teknike. Kjo letër bie në kundërshtim me letrën po të OTP-së të datës 17 dhjetor me nr.8626/3 prot. në të cilën nuk pranohet nga OTP-ja të paraqesin kontratën finale të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Komisioni vlerësoi se pranimi i kontratës nga ana e komisionit, me çfarëdo ndryshimi, do të çonte në diskriminimin e ofertuesve në tender.

c) Përmbledhje e ofertave të paraqitura

Nga shqyrtimi i procedurave të tenderit rezultoi se OTP-ja ka paraqitur një ndër dokumentet e kërkuara në shkelje të kërkesave të përcaktuara në ftesën për tender, pavarësisht sqarimeve të bëra gjatë procesit të negocimit të kushteve të projektkontratës me të dy ofertuesit, si dhe të letrës së dërguar nga këshilltari i privatizimit, si dhe të letrës së dërguar nga Ministri i Financave më datë 16 dhjetor 2003. Më konkretisht, banka OTP paraqiti kontratën e shitjes së aksioneve, të nënshkruar me ndryshime (materiali bashkëlidhur), gjë që Komisioni e vlerësoi si shkelje thelbësore të kushteve të tenderit dhe të deklaratës së përfaqësuesve të ofertuesit OTP për njohjen dhe zbatimin e kushteve të tenderit. Për rrjedhojë, Komisioni u detyrua të vazhonte procedurën duke bërë vlerësimin e ofertave financiare e teknike të ofertuesit Raiffeisen Bank.

d) Kriteri kryesor i vlerësimit të ofertës

Komisioni vazhdoi me procedurat e vlerësimit, duke i dhënë ofertuesit Raiffeisen Bank:

- a) 75 pikë për ofertën financiare,
- b) 5 pikë për planin e biznesit,
- c) 13. 22 pikë për fortësinë dhe eksperiencën financiare.

e) Përmbledhje e rezultateve të procedurave të tenderit, së bashku me listën e ofertuesve që rezultojn nga vlerësimi i ofertave:

Ofertuesi fitues Raiffeisen Bank

Oferta financiare 126 milionë dollarë amerikanë në *cash*.